

KUD 327(4/9):65(496.51)

**NDIKIMI I KRIZËS GLOBALE, IDENTIFIKIMI I BARRIERAVE
KRYESORE DHE NDIKIMI I TYRE NË ZHVILLIMIN E
MENAXHIMIT TË BURIMEVE TË FINANCIMIT TË BIZNESEVE TË
VOGLA DHE TË MESME NË KOSOVË**

*Fjolla Trakaniqi,
fjollatrakaniqi@gmail.com*

Abstrakt

Menaxhmi përfshin të gjithë procesin menaxhues në një ndërmarrje duke u nisur nga planifikimi, punësimi, drejtimi, bashkërenditja, ekzekutimi e deri te kontrolli i saj.

Në aktivitetet e financimit të ndërmarrjes përfshihet marrja e vendimeve lidhur me financimin dhe shfytëzimin sa më racional të mjeteve në ndërmarrje. Në këto aktivitete njëherit përfshihet edhe zgjidhja e problemeve të cilat janë të lidhura me burimet e financimit, lartësia e mjeteve dhe struktura e mjeteve financiare.

Në Kosovë ndërmarrjet e vogla dhe të mesme mund të marrin kredi nga bankat dhe atë me kamatë të lartë. Si mjet garantues për marrjen e kredisë nevojitet pengu, hipoteka në vlerën për dy herë më të madhe se kredia. Kredia jepet për veprimtari të ndryshme ekonomike, si për kapital qarkullues ashtu edhe për kapital themelor. Edhe disa organizata mikrofinanciare lejojnë kredi me vlerë më të vogël se sa bankat, me kamatë të njejtë mirëpo me afat më të shkurtër.

Fjalët kyçe: Menaxhimi, financimi, ndërmarrje, kredi, kapital, kamatë, burime të financimit, mjete financiare, aktivitete të financimit.

JEL Klasifikimi: B26, GOO, G01, G29, H12, F24, E52, E43.

1. Hyrje

Menaxhimi i burimeve të financimit hap perspektivë të zhvillimit më të shpejtë të bizneseve të vogla dhe të mesme duke mundësuar ngritjen e efikasitetit të qëndrueshmërisë së këtyre bizneseve.

Problemi kryesor me të cilin po ballafaqohen këto biznese në Kosovë është mungesa e burimeve financiare që njëherit e pengon krijimin e bizneseve të reja si dhe zhvillimin dhe zgjerimin e bizneseve ekzistuese.

Financimi dhe zhvillimi bashkëkohor i bizneseve të vogla dhe të mesme mund të hapë perspektivë për rritjen e punësimit dhe zvoglimin e varfërisë.

Nga ky aspekt financimi i bizneseve të vogla dhe të mesme duhet të përkrahët në formë institucionale nga administrata qendrore dhe lokale nëpërmes mbështetjes financiare, duke aplikuar stimulim në politikën tatimore, monetare, kreditore, doganore, etj. Studimet e këtij punimi do të bazohen në hulumtimet që mundësojnë identifikimin e faktorëve dhe zgjedhjen metodave për përcaktimin e modelit të qëndrueshëm të menaxhimit të suksesshëm të bizneseve të vogla dhe të mesme në ekonominë e Kosovës.

2. Ndikimi i krizës globale në burimet e financimit në Kosovë

Në fillim kriza përfshiu ekonominë e vendeve më të zhvilluara kapitaliste, ku dhe ishte me intenzitet më të lartë. Globalizimi i ekonomisë, i tregjeve dhe i financave botërore bëri që kriza, edhe pse lindi e u zhvillua vetëm në disa shtete të pasura e të fuqishme, të përhapej shpejtë dhe nuk kurseu asnjë shtet në tërë botën.

Kështu, kriza ekonomike globale në mënyrë direkte apo indirekte ndikoi edhe në Kosovë, përkitazi me investimet e huaja. Tani vërehet mungesë e investimeve të huaja dhe gjendja ekonomike dhe sociale po rëndohet edhe më shumë.

Republika e Kosovës po përballet me shumicën e problemeve, të cilat i kanë pasur edhe shtetet tjera postkomuniste dhe shtetet që kanë dalë nga konflikti.

Republika e Kosovës është shteti më i varfër në Evropë. Të bësh biznes është e vështirë, Kosova është ranguar e 113 – ta nga Banka Botërore për bërjen e biznesit më 2009.

Bankat komerciale në vend po përcillen me një trend negativ të kreditimit. Është shtuar përqindja e kredive të këqija jopërfomuese. Mirëpo, ka një rritje të kreditimit por në një masë shumë më të vogël se sa viteve të kaluara.

Marrëdhënja midis performancës së biznesit dhe performancës së bankave qëndron në raport proporcional dhe përkeqësimi i gjendjes financiare dhe komerciale tek bizneset reflektohet në përkeqësimin e gjendjes financiare dhe komerciale edhe të bankave.

Planifikimi i joefikas i rrjedhës së parasë është rezultat i krizës por edhe i mos planifikimit të kompanive vendore. Kreditë janë zvogëluar, sepse bankat rezervohen në këtë kohë krize, meqë kanë informacione se kompanitë do të kenë vështirësi për kthimin e kredive, prandaj në kohë krizash bankat janë më konservative, e kjo gjë po ndodhë edhe në Kosovë.⁸⁵

Në Kosovë nuk ka ndonjë përmirësim të financimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme e sidomos të financimit të bizneseve fillestare. Është një

⁸⁵ Prof.Dr.Isak Mustafa, "Konferenca e nëntë ndërkombëtare biznesi dhe punësimi", 2010, Prishtinë, fq.41.

numër i vogël i bankave komerciale në Kosovë për këtë ato kanë një sjellje monopoliste në dhënie të kredive, në afat të kthimit të kredive, janë shumë të shtrenjta dhe jo ekonomike për shumë biznese që kanë nevojë për financim. Sipas raportit të BQK-së në vitin 2009 73.3 % të bizneseve janë pjesëmarrës në kredi bankare ndërsa në vitin 2008 ka pasur 76.3%. Nga kjo shihet se në vitin 2009 ka një rënje prej 3% pjesëmarrje në kredi bankare.

3. Identifikimi i barrierave kryesore dhe ndikimi i tyre në zhvillimin e menaxhimit të burimeve të financimit të bizneseve të vogla dhe të mesme

Agjencia për mbështetje si dhe institucionet tjera si ato vendore ashtu edhe ato ndërkombëtare, në bazë të hulumtimeve periodike që i kanë bërë, kanë ardhur në përfundim se ekzistojnë barrierat e shumta dhe të natyrave të ndryshme. Agjencia për mbështetje të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme pas hulumtimeve ka arritur të bëjë sistemimin dhe adresimin e barrierave kryesore të cilat për vite të tëra adresohen nga sektori i bizneseve të vogla dhe të mesme në Kosovë, nga përfaqësues të biznesit dhe autoritete publike shkencore, akademike dhe politike.

Disa nga barrierat kryesore janë:

- Barrierat e përgjithshme,
- Ambienti legal,
- Promovimi i ndërmarrjes,
- Financimi,
- Teknologjia.

Barrierat kryesore në financim janë: pjesëmarrja në kapital dhe kreditë.

Në pjesëmarrjen në kapital ndikojnë:

- Padisponueshmëria e kapitalit vetanak,
- Rrjedha e kufizuar e investimeve të huaja,
- Fitimi i ultë në shumicën e bizneseve.

Te kreditë ndikojnë:

- Lartësia e kolateralit dhe kërkesave për garanci,
- Grejs periudha të shkurtra të kthimit të kredive,
- Shkalla e lartë e interesit,
- Vështirësitë në qasje afatgjate financiare në institucionet kreditore.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës në bashkëpunim me Zyrën Civile Ndërkombëtare (ICO) kanë organizuar konferencën e përbashkët me titull: Burimet e financimit për rritjen ekonomike: A ka para të mjaftueshme në Kosovë ?

Korniza makroekonomike për rritjen ekonomike, ishte tema e prezantuar nga z. Renzo Daviddi, kreu i Zyrës Ndërlidhëse të Komisionit

Evropian. Sipas tij qasja në financim është njëra ndër barrierat kryesore për sektorin privat në Kosovë. Kosova ka para që mund të investohen ato duken edhe nga depozitat e larta bankare, por kostoja e financimit është e lartë për shkak të riskut të perceptuar nga bankat.

Ndërsa z.Robert Wright prezantoi temën “Financimi kreditor për sektorin privat”.

Sipas tij tregu në total i huave është 1.3 miliardë euro prej të cilave 73% janë kredi për sektorin e biznesit. Sektori bankar ka 500 milionë euro depozita të pashfrytëzuara. Wright ka thënë se nga aspekti i bankave problematike nuk është vetëm mosshfrytëzimi i këtyre parave por edhe numri i vogël i firmave që përdorin kreditë për të investuar në bizneset e tyre, që në total është 23.5% i bizneseve në Kosovë, shifër kjo ende e ultë krahasuar me vendet e rajonit. Sipas tij sektori i tregtisë prinë me afro 55% të kredive të marra në banka. Ai ka shfaqur vërejtjen e tij se fokusimi në ndërtimtari i ekonomisë mund të ketë pasoja në rast se këto prona që ndërtohen nuk shitën. Gjithnjë sipas z.Wright, në Kosovë ka nevojë për krijimin e mundësive të reja për lëshimin e kredive sidomos në sektorin e shërbimeve komunale, telekomit, shëndetësisë, teknologjisë, për faktin se në këto fusha risku mund të jetë më i ultë etj.⁸⁶

3.1 Pasojat e normave të larta të interesit

Normat e larta të interesit në kreditë e bankave komerciale në Kosovë vështirësojnë financimin dhe zhvillimin e bizneseve, vlerësojnë përfaqësuesit e bizneseve në Prishtinë dhe ekspertët e çështjeve ekonomike. Bizneset në Kosovë nuk mund të zhvillohen pa mbështetjen financiare të bankave komerciale, por sistemi i financimit të këtyre bizneseve është tejet i shtrenjtë, për shkak të normave të larta të interesit nga kreditë e bankave, vlerësojnë përfaqësuesit e bizneseve në Kosovë dhe ekspertët e çështjeve ekonomike. Agim Shahini, drejtues i Aleancës Kosovare të Bizneseve, thotë se ngritja e normave të interesit nga bankat komerciale në gjithë botën, është pasojë e krizës financiare botërore, por niveli i normave të interesit në Kosovë, sipas tij, është më i larti. “Në ato vende që ka krizë, e kanë gjetur rrugën që t’i ulin normat e interesit dhe të dalin nga kriza. Bankat në Kosovë e kanë gjetur mënyrën tjetër, që t’i ndalojnë kreditë, t’i rrisin normat e interesit dhe kështu t’i detyrojnë bizneset që të shkojnë drejt falimentimit”. “Kjo do të thotë se bizneset gjenden në një pozitë të vështirë, duke marrë për bazë normat e larta të interesit prej 15 deri në 17 për qind të bankave, duke marrë parasysh politikat tregtare dhe fiskale jo të favorshme dhe duke u nisur nga fakti bazë se fuqia konsumuese në Kosovë për çdo ditë po varfërohet”, thotë Shahini.

Ngjashëm vlerëson edhe Muhamet Sadiku, ekspert për çështje të ekonomisë, i cili thotë se me normat aktuale të interesit në kreditë bankare në Kosovë, është vështirë të ndërtohet konkurrenca e bizneseve. “Këto norma janë

⁸⁶ <http://www.bqk-kos.org/?cid=1,52,321>

të larta edhe në aspektin e krahasimeve rajonale dhe ndërkombëtare. Do të thotë, kapitali në Kosovë e ka çmimin më të lartë në raport me të gjitha këto zhvillime në tregun rajonal”. “Kemi ardhur në një situatë, ku bankat janë akomoduar me norma të larta të kamatës dhe flitet që kemi sistem bankar të qëndrueshëm, ndërsa kemi biznese të dobëta. Do të thotë, i tërë sistemi bankar dhe formula e financimit të tyre janë joadekuate në raport me nevojat reale të bizneseve në Kosovë”, thotë Sadiku.

Vitin e kaluar, ne kemi pasur rreth një mijë biznese që janë mbyllur dhe kjo është një shqetësim për të gjithë ne. Ky është një argument se duhet të ketë reforma të mëdha në gjithë spektrin, qoftë ekonomik, qoftë atë të ndryshimeve të politikave tregtare, financiare, fiskale. Kjo do ta ndihmonte biznesin”.⁸⁷

3.2 Mundësit e financimit të bizneseve në Kosovë

Hulumtimi i Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë, mbi qasjen në kapital, nxori në pah shumë çështje, për të cilat ekspertët dhe përfaqësues të institucioneve bankare në Kosovë duhet t’i kushtojnë rëndësi. Kështu u tha në Konferencën e organizuar nga Oda Ekonomike Amerikane. Drejtori ekzekutiv i Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë, Lekë Musa, tha se bizneset në Kosovë, burimet e tyre të financimit, i shfrytëzojnë, kryesisht, përmes bankave, kursimeve të tyre dhe huamarrjes, duke mos pasur shumë informata rreth burimeve të tjera të financimit që do të ishin më të përshtatshme për ta. “Ende nuk është eksploruar i tërë sistemi financiar, do të thotë, burime të tjera të financimit, përveç atij bankar. Pastaj, si një problem kyç i zhvillimit ekonomik, është identifikuar edhe mungesa e financimit të bizneseve, të cilat sapo lindin. Ndërsa, nga sistemi bankar në vend, është kërkuar që të përmirësohet raportimi financiar, përkatësisht, të përmirësohen raportet e pasqyrave financiarë, me të cilat prezantohen bizneset”, thotë Musa. Ndërsa, sa i përket normave të interesit, hulumtimi thekson se, ato janë të krahasueshme të rajonit. “Si propozime për ulje të normave të interesit, është vetë zgjerimi i bazës së ofruesve të kredive, do të thotë, që të zgjerohet tregu i kapitalit, që të shtohet numri i bankave, liberalizimi i tregut, pastaj jepet si një opcion edhe ndërhyrja nëpërmjet politikave të ndryshme qeveritare, ku ata do të bënin atë që është paraparë në ligjin e ri mbi Bankën Qendrore”, ka sqaruar Lekë Musa, nga Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë. Ekspert të kësaj fushe, thanë se, si burime tjera të financimit, që bizneset mund të përdorin janë edhe investimet në aksione si dhe përdorimi i instrumenteve të tjera financiare.⁸⁸

⁸⁷ <http://www.kohaditore.com/index.php?cid=1,5,22647>

⁸⁸ <http://www.koha.net/index.php?cid=1,5,14863>

4. Huadhënjet për bizneset e vogla dhe të mesme në Kosovë nga maji i vitit 2008 deri në prill të vitit 2009

Tabela 1: Kreditë bruto për korporata sipas sektorëve.

	Pril l '08	Ma j '08	Qe r '08	Ko rr '08	Gu. '08	Sht '08	Tet '08	Në n '08	Dh j '08	Jan '09	Sh k. '09	Ma '09	Pri. '09
Bujqësia	27.9	29.2	30.4	31.1	31.8	32.2	33.5	33.3	33.3	33.3	38.4	39.3	34.3
Industri, Energji, Ndërtim	162.5	168.9	169	172.8	178.8	167.0	162.9	163.4	160.2	162.4	175.3	193.9	192.4
-Miniera	0.5	0.5	0.6	0.6	0.6	0.8	0.8	0.8	0.8	0.8	4.1	3.7	3.6
-Industri,	104.1	109.8	109.5	111.5	112.6	100.6	96.7	96.4	93.8	92.2	101.5	115.0	110.2
-Industri përpunues e (ushqim)	76.5	79.2	77.5	79.4	79.5	79.5	77.4	77.2	75.1	74.3	78.4	86.3	83.1
-Industri përpunues e(Vaj, Kimikale)	14.0	16.8	18.2	18.6	19.7	19.5	17.9	17.7	17.1	16.3	21.3	26.9	25.4
-Energjia elektrike,g azi dhe uji	13.7	13.7	13.7	13.5	13.5	1.6	1.5	1.5	1.6	1.6	1.7	1.8	1.8
-Ndërtim	57.9	58.6	59.0	60.7	65.6	65.9	65.5	66.2	65.6	69.3	69.7	75.1	78.6
Shërbime:	605.1	620.2	646.2	653.7	652.1	663.1	690.4	710.8	704.8	707.0	709.0	702.4	712.8
-Tregti	463.3	474.9	490.8	489.9	490.9	498.0	499.6	508.5	504.7	507.5	548.9	536.7	524.9
-Tregti shitjes me shumicë	404.1	414.7	426.8	423.5	423.8	431.3	434.3	441.4	437.5	438.5	469.3	459.1	447.6
-Hotelet dhe restorantet	36.8	40.2	42.4	44.0	44.0	43.6	43.5	45.0	45.1	45.2	47.7	47.6	47.7
-Tregti tjetër	22.4	20.0	21.6	22.4	23.0	23.1	21.8	22.1	22.0	23.9	32.0	30.0	29.6
-Shërbime financiare	6.4	6.5	9.6	10.4	6.6	6.4	5.8	6.0	6.0	5.7	8.7	11.0	10.8
-Shërbime tjera	135.5	138.8	145.7	153.3	154.7	158.0	184.4	195.8	194.2	193.8	151.4	154.7	177.1
Gjithsejt:	800.9	823.8	851.1	863.2	868.2	867.8	891.1	911.8	902.4	906.8	927.2	940.4	944.2

Burimi: Agjencia për mbështetjen e NVM-ve, 2009, Raport vjetor, fq.29.

Nga tabela e mësipërme vërehet se kreditë bruto për korporata kanë një tendencë rritje nga muaji në muaj krahasuar muajin prill të viti 2008 me po të njejtin muajin në vitin 2009 vërehet një rritje prej 17.9%.

Bazuar në kreditë bruto të korporatave sipas sektorëve nga periudha e muajit prill 2008 deri në periudhën e muajit prill 2009 rritje më të madhe ka sektori i Industrisë përpunuese (vaj, kimikale), me 81.43%. Pas këtij sektori radhitet sektori i shërbimeve financiare me një rritje prej 68.75% krahasuar mes periudhës prill 2008 - prill 2009. Rritja më e vogël është prezente te sektori i minijerave ku krahasuar me muajin prill 2008 në muajin prill 2009 vërehet një rritje për vetëm 7.2%.

Në tabelën e mësipërme ku janë pasqyruar kreditë bruto për korporata sipas sektorëve, te sektori i energjisë elektrike, gazit dhe ujit vërehet një rrënjë për - 66.86 % për prill 2009 krahasuar me periudhën prill 2008.

Tabela 2. Kredit Bruto për Korporata dhe ekonomi familjare.

	Pr ill 0 8	Ma j '08	Qe r '08	Ko rr '0 8	Gu. '08	Sht '08	Tet '08	Në n '08	Dh j '08	Jan '09	Sh k. '09	Ma '09	Pr. '09
Kredit ë bruto dhe të ngjash me për Korpo rata financi are dhe Jofina nciare dhe ekono mi familj are		1.0 52. 8	1.0 89. 7	1. 11 4.	1.1 24. 2	1.1 30. 2	1.1 60. 8	1.1 87. 9	1.1 83. 4	1.1 88. 6	1.2 11. 2	1.2 29. 8	1.2 3 ...

Burimi: Agjencia për mbështetjen e NVM-ve, 2009, Raport vjetor, fq.30.

Nëse krahasojmë kreditë bruto të ekonomive familjare nga muaji në muaj atëherë rritja më e madhe është në muajin qershor të vitit 2008 ku

=====

krahasuar me muajin maj të vitit 2008 kemi rritje për 3.5% ndërsa rënje kemi në muajin dhjetor për 0.39% krahasuar me muajin nëntor të vitit 2008.

Marrë në përgjithësi tabela e mësipërme paraqet një rritje prej 21.51% nga muaji prill 2008 deri në muajin prill 2009 për kreditë bruto të korporatave dhe ekonomive familjare.⁸⁹

4.1. Kushtet ekonomike të kredive në vitin 2009

Kushtet ekonomike varen nga: lloji i kredive, maturiteti, kamata, shuma maksimale e kredisë, kushtet për marrje të kredisë etj.

Për nga shuma e kredisë klasifikimi i tyre mund të varirojë ndërmjet bankave, por përgjithësisht ato ndahen në të vogla deri në 10 000 euro, të mesme deri në 100 000 euro dhe të mëdha mbi 100 000 euro. Kreditë jepen bazuar në mundësinë që biznesi ka për kthimin e tyre, por gjithashtu përveç pengut të luajtshëm duhet të sigurohen me patundshmëri.

Struktura e kredive sipas sektorëve edhe në vitin 2008 ka mbetur e ngjajshme me periudhat e kaluara. Pjesmarrjen më të madhe në kredi e kanë ndërmarrjet me 76.3 % të gjithsej kredive (77.5% në 2007), ndërsa ekonomitë familjare 23.7% (22.5% në 2007). Në kuadër të kredive të ndërmarrjeve, dominojnë ndërmarrjet që merren me tregti me një pjesëmarrje prej 42.6%. Sektori me pjesëmarrjen më të ultë në kreditë e sektorit bankar vazhdon të jetë sektori i bujqësisë, përfaqësuar me vetëm 4.1% në gjithsej kreditë. Me gjithë atë, në vitin 2008 vërehet një rritje në kreditë e lëshuara ndaj këtij sektori.

⁸⁹ *Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, "Agjencia për mbështetjen e NVM-ve", raporti vjetor 2009, Prishtinë, fq.29.*

Përfundim

Zhvillimi i menaxhimit të burimeve të financimit të bizneseve të vogla dhe të mesme në Kosovë mund të kontribuojë në zhvillimin efikas të bizneseve të vogla dhe të mesme në përputhje me parimet e ekonomisë së tregut.

Menaxhimi i burimeve të financimit do të ndikojë në përmirësimin e pozitës materiale financiare të bizneseve të vogla dhe të mesme në Kosovë. Menaxheri i mirë duhet praktikuar nëse sigurohen hua dhe përdoren për fitim. Një menaxhim i tillë përfshin: njohjen e fluksit të parave, parashikimin e nevojës për para, planifikimin e huamarrjes në një periudhë më të përshtatshme dhe vërtetimin e aftësisë paguese të biznesit.

Pasi që bizneset nuk disponojnë ende fonde për të financuar të gjitha nevojat e tyre, bankat luajnë një rol të rëndësishëm për financimin e tyre. Mirëpo, normat e larta të interesit i'u vështirësojnë bizneseve marrjen e kredive bankare.

Ulja e normave të interesit do të ndihmonte në shmangjen e problemeve që vërehet në menaxhimin financiar të bizneseve, që kanë të bëjnë me pamundësinë e kthimeve të kredive të huazuara nga bankat. Në të njëjtën kohë, kjo do të ndihmonte në hapjen e rrugëve të reja për financimin e biznesit, në rritjen e eficiencës ekonomike dhe të cilësisë së menaxhimit të biznesit, në zgjerimin e bizneseve e sidomos atyre prodhues. Kjo do t'i shërbente në të njëjtën kohë bizneseve duke iu mundësuar që zgjerimin e biznesit ta sigurojnë përmes institucioneve financiare. Njëherë kjo do të ndikojë në përmirësimin e situatës ekonomike të bizneseve ekzistuese dhe krijimin e bizneseve të reja.

Literatura

1. Konferenca e nëntë ndërkombëtare biznesi dhe punësimi, IFK, Prishtinë, 2010.
2. Civici, Adrian “Krizë financiare ...apo globale?”, Tiranë, 2010.
3. Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, “Agjencia për mbështetjen e NVM-ve”, raporti vjetor 2009, Prishtinë
4. Raportet financiare periodike dhe vjetore , BQK, 2008/2009, Prishtinë.
5. <http://www.kohaditore.com/index.php?cid=1,5,22647>
6. <http://www.koha.net/index.php?cid=1,5,14863>
7. <http://www.bqk-kos.org/?cid=1,52,321>